

## **Te ushqyerit ne spitalin Meyer**

### *Kur ushqimi ndihmon shërimin*

#### **Vaktet ushqimore për fëmijët dhe adoleshentët e shtruar në spital**

Në shtëpi ne shkollë e në pushime, mëngjesi, dreka dhe darka janë momente shumë të rëndësishme; i japin gjallëri ditës dhe kanë efekt inkurajues. Në Spital, të ngrënit ka një rëndësi të veçantë sepse ushqimi është pjesë përbërëse e shërimit.

Të ushqyerit në mënyrë korrekte është një faktor i jashtëzakonshëm për shëndetin dhe karakteristikat ushqyese të ushqimeve kthehen në një “përbërës” të çmuar në procesin e shërimit. Në praninë e patologjive të rëndësishme veçoritë ushqyese marrin një rol specifik shërues e mund të ndihmojnë në trajtimin e ndërlikimeve.

Për këto motive kemi kërkuar nga ndërmarrja që furnizon repartet dhe mensën me ushqime, që të përdorin prodhime me cilësi, për të cilat është e mundur të shënohet prejardhja, duke ju dhënë përparsi ushqimeve të stinës dhe atyre biologjike.

Kur dieta është e lirë, është e mundur zgjedhja në bazë të ofertës së menu-së, në rast të kundërt, kur është e nevojshme të ndiqet një dietë e veçantë, ndërhyjnë dietista e spitalit Meyer e cila shpjegon pse disa ushqime janë më të preferuara se të tjerat.

Duam të vëmë në dukje vlerat edukative të të ushqyerit në Spital, cilësinë e shërbimit, vlefshmërinë ushqyese të të ngrënit, duke respektuar kulturën e të ushqyerit zonal e natyrisht kënaqësinë e të shijuarit, pra

Ju bëftë mirë!

Drejtorja

#### **Ushqimi për prindërit dhe kujdestarët**

Mensa e Meyer-it, në përputhje me karakteristikat dhe kualitetin e ushqimit në spital, është në dispozicion për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve si dhe të rinjve të shtruar në spital.

Nënat që ushqejnë fëmijën me gji (për vitin e parë të jetës) mund të hanë falas duke paraqitur në mensë një biletë të gjelbër të cilën mund ta marrin nga stafi i repartit.

Një prind (ose kujdestar) i cili dëshiron të hajë në mensë, mund të marrin nga stafi i repartit një biletë të kuqe e cila duhet të dorëzohet në mensë duke paguar 5 euro.

Anëtarët e tjerë të familjes mund të hanë në mensë duke paraqitur një biletë të verdhë të cilën mund ta tërheqin pranë “box- urp” dhe duke paguar 6,50 euro; Nga e hëna deri të premten, mund të hyjnë në mensë vetëm pas orës 14:00, të shtunë dhe gjatë ditëve të pushimit gjatë gjithë orarit të hapjes së mensës.

Në raste të veçanta, një prind mund të hajë në repart duke paguar 6.50 euro në momentin e prenotimit në mensë. Në asnjë rast nuk është e mundur të hahet brenda reparteve të reanimimit sub-intensiv, kujdesit intensiv neonatal, reanimim dhe repartit neurosensorial.

#### **Mos harroni**

Ushqimet e konsumuara në repart apo në mensë duhet të paguhet drejtpërdrejt në mensë.

Mensa është e hapur 7 ditët e javës. Për drekë në ditët e punës nga ora 11.45 deri në orën 15.00 edhe të shtunë, të dielë e ditët e festave nga ora 12.00 deri në orën 14.00, për darkë çdo ditë nga ora 19.15 deri në orën 20.30